

Znj. Gabriele Gaube

Znj. Gabriele Gaube ka diplomuar për drejtësi në Universitetin Trier në Republikën Federale të Gjermanisë në vitin 1990. Pas përfundimit të studimeve pasuniversitare si dhe të provimit të dytë shtetëror, ajo fitoi titullin pasuniversitar në drejtësi në vitin 1993.

Atë vit ajo është emëruar Gjykatëse në Gjykatën Administrative në Berlin, ku ajo shërbeu deri në delegimin e saj në muajin mars të vitit 1999 në Ministrinë e Drejtësisë në Berlin, Departamenti për Arsimim dhe Aftësim/Bordi për Shqyrtimin e Ligjeve. Pas delegimit të saj në muajin janar të vitit 2003 ajo u emërua Kryegjykatës i Gjykatës Administrative dhe në muajin dhjetor të vitit 2004 Gjykatëse e Gjykatës së Lartë Administrative.

Në muajin janar 2005, ajo u rikthye në detyrën e saj në Gjykatën e Lartë Administrative në Berlin-Brandenburg (gjykata e apelit dhe gjykata e shkallës së fundit lidhur me legjislacionin e shteteve federale të Berlinit dhe Brandenburgut) ku, në muajin janar të vitit 2007, ajo u emërua zëvendës Kryegjykatës.

Nga muaji nëntor 2008, ajo ka qenë në një pushim të jashtëzakonshëm nga Gjykata e Lartë Administrative dhe është dërguar nga Republika Federale e Gjermanisë në misionin e EULEX-it në Kosovë. Atje, ajo u emërua gjykatëse ndërkombëtare në Panelin e Apeleve në Gjykatën Supreme për rastet e Agjencisë Kosovare të Pronës dhe Gjykatës për Apele për Ankesat drejtuar Agjencisë Kosovare të Pronës, respektivisht nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar dhe shefi i misionit të EULEX-it në Kosovë në muajin janar 2009. Në muajin prill 2010, nga ajo është kërkuar që të mbulojë edhe proceset civile në përgjithësi si dhe proceset penale duke ju referuar kështu kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Më 17 dhjetor 2009, shefi i misionit EULEX në Kosovë, e ka emëruar znj. Gaube zëvendësuese të gjykatësit të EULEX-it në Panelin për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të EULEX-it në Kosovë në kohëzgjatje prej një viti.

Znj. Magda Mierzewska

znj. Magda Mierzewska ka diplomuar në Universitetin e Gdańsk, në Poloni, dhe ka arritur shkallën master në lëmin e drejtësisë (LLM) në vitin 1980 dhe ka kaluar me sukses Provimin Shtetërorë të Polonisë për postet gjyqësore në vitin 1982. Ajo u pranua në Dhomën për Këshillim Ligjorë në Gdańsk në vitin 1989 dhe ka arritur edhe një master në të Drejtën e Bashkimit Evropian në Universitetin Leicester në vitin 2005.

znj. Mierzewska ka punuar si mësimdhënëse në Fakultetin Juridik, Departamenti i së Drejtës Ndërkombëtare, në Universitetin në Gdansk nga viti 1982 deri në vitin 1991. Ajo u emërua si Avokat përfaqësues në Sekretariatit për të Drejta të Njeriut pran Komisionit Evropian në Strasbourg në vitin 1993. Pastaj ajo nga viti 1998 ishte e punësuar si avokat në Zyrën e Regjistrimit në Gjykatën Evropiane për të Drejta të Njeriut në Strasbourg, France.

Ajo ka një përvojë të gjatë të trajnimeve ndërkombëtare në çështje të ndryshme të pavarura dhe procedurale për të drejtat e njeriut, kryesisht për avokatë, gjykatës, prokurorë dhe organizata jo-qeveritare.

Publikimet e shumta akademike të znj. Mierzewska përfshijnë: Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore: Dhjetë vite pas Ratifikimit, Zyra për Informim e Këshillit të Evropës në Varshav me 2004; Dhjetë vite për: Popullariteti i Konventës në Poloni (bashkë-autorë), Trajtimi Evropian i Ligjeve për të Drejtat e Njeriut, botimi i 4, 2004; Dhjetë vite për: E drejta sipas praktikës së mëparshme Polake Voluminoze dhe Interesante (bashkë-autorë), Trajtimi Evropian i Ligjeve për të Drejtat e Njeriut, Botimi 5, 2004; Standardet e themeluara sipas të drejtës së praktikës së mëparshme të KEDNj (Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut) në Rastet lidhur me shpronësimet dhe aplikimin e tyre për kërkesat pronësore Gjermane, Instituti Polak për Marrëdhënie të Jashtme, 2005; Procesi i pranimit të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore në Poloni dhe Sllovaki në: Pranimi i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, eds. H. Keller, A. Stone-Sweet, Oxford University Press, muaji maj, 2008.

znj. Mierzewska është emëruar si anëtare e Panelit të EULEX-it për të Drejta të Njeriut nga ushtruesi i detyrës së shefit të misionit të EULEX-it me 4 maj, 2010.